

**SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE
“ONE ALBANIA” SHA**

STATUTI I SHOQËRISË

**STATUTI I SHOQËRISË
SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE
“ONE ALBANIA” SHA**

Në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, i ndryshuar.

ONE ALBANIA SHA ushtron aktivitetin e saj në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Nr.12910, dated 27.11.1995, dhe vijuesit e tij, gjithashtu e regjistruar pranë organeve tatimore me NUIS J61814094W, sipas ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në zbatim të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, duke nisur që sot më datë **01.01.2023**, përshtatet Statuti i kësaj Shoqërie si më poshtë:

KREU I

**EMRI I SHOQËRISË – AKSIONARËT – OBJEKTI – SELIA KOHËZGJATJA ADRESA
E FAQES SË INTERNETIT**

**Neni 1
Emri i Shoqerisë**

1.1 Emri i Shoqerisë aksionare është “ONE Albania” SHA.

**Neni 2
Aksionarët**

2.1 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, aksionarët e Shoqerisë janë:

- a) **Albania Telekom Invest AD** do të zoterojë 812,997,000 të aksioneve të Shoqerisë së mbijetuar që përfaqëson 94,116 % të kapitalit të saj aksionar.
- b) **4iG Albánia Kft.** do të zoterojë 18,541,000 të aksioneve të Shoqerisë së mbijetuar që përfaqëson 2,146 % të kapitalit të saj aksionar.
- c) **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** do të zoterojë 21,983,600 të aksioneve të Shoqerisë së mbijetuar që përfaqëson 2,545 % të kapitalit të saj aksionar.
- d) **Posta Shqiptare SHA** do të zoterojë 3,933,049 të aksioneve të Shoqerisë së mbijetuar që përfaqëson 0,455 % të kapitalit të saj aksionar.
- e) **Aksionarët e Tjerë** do të zoterojnë 6,372,173 të aksioneve të Shoqerisë së mbijetuar që përfaqëson 0,738 % të kapitalit të saj aksionar.

**Neni 3
Objekti**

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM dhe telefoni fikese.
- b) Komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio.



- c) Komunikim bazë në rrjetin ndër-qytetas që lidhen me transmetimin radio.
- d) Komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale;
- e) Komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- f) Komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teletekst and videotekst;
- g) Detar, ajror, hapësinor dhe radio-komunikim satelitor;
- h) Shërbime me vlerë të shtuar, shërbime komunikimi publik me monedha, karta krediti ose karta të parapaguara, etj.
- i) Ofrimi i shërbimit të roamingut ndërkombëtar;
- j) Ofrimi i telefonisë fiks;
- k) Ofrimi i shërbimeve të arkëtimeve të klientëve të palëve të treta në emër dhe për llogari të tyre.
- l) Në përgjithësi Shoqëria autorizohet të ofrojë çdo aktivitet dhe/ose shërbim tjetër të cilat janë në përputhje me dispozitat e Ligjit të Komunikimeve Elektronike në fuqi dhe ashtu sikurse mund të modifikohet herë pas here, si dhe shërbimet të cilat janë në përputhje me Autorizimin e Përgjithshëm dhe Individual të lëshuar nga AKEP.
- m) Shoqëria autorizohet të ofrojë çdo veprimtari radio televizive dhe/ose shërbime të tjera të cilat janë në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9742, datë 28.5.2007, "Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë" aktualisht në fuqi dhe siç mund të ndryshohet në të ardhmen, si dhe me dispozitat e Ligjit 8410, datë 30.9.1998, "Për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe siç mund të ndryshohet në të ardhmen.
- n) Shoqëria autorizohet të ofrojë zgjidhje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT) për biznese dhe pajtimtarë. Nga këto zgjidhje përfitojnë si konsumatorët ashtu dhe shoqëritë e çdo sektori të industrisë, qofshin ato biznese të vogla, të mesme apo korporata të mëdha.
- o) Shoqëria autorizohet të ofrojë, për shoqëritë filiale në Shqipëri apo jashtë saj, shërbime konsulencë dhe manaxhimi, si dhe çdo shërbim tjetër në lidhje me aktivitetet e këtyre shoqërive.
- p) Zgjidhja GPS (kombëtare dhe ndërkombëtare), Zgjidhja Cloud, zgjidhja Hosting, Cloud PBX, ERP dhe shërbimet cloud të financës, shërbimet IT (LAN/WAN), Manaxhimi internetit pa kabull (Wi-Fi), projekte të tjrrera që lidhen me IT, dizenjimi i faqes së internetit & hostimi i faqes së intetnetit, Domain (shitia e domeineve), ngarkuesit elektrike (kompjuterat dhe programet), pajisjet IoT, kompjuterat dhe programet, pajisje elektroshtëpiake, pajisje të ndryshme IT.
- q) Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i objektit të saj, Shoqëria mund:
 - i. Të kryejë çdo aktivitet në lidhje me prona të luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, finanziar, dhënie me qira apo hipoteke, ose çdo aktivitet të çdo lloji tjetër në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi, që mund të konsiderohet si i dobishëm apo i nevojshëm nga organet drejtuese te Shoqërisë sipas percaktimeve te ketij Statuti dhe në mënyrë që të arrihet qëllimi i Shoqërisë,
 - ii. Të kryejë aktivitete reklamuese dhe botuese.
 - iii. Të nënshkruajë bono ose garanci të çdo lloji, përfshirë garancitë e pagesës së një kambiali.
 - iv. Të përfitojë, direkt ose indirekt, interesa në shoqëri të tjera të cilat kanë objekt të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj.
 - v. Të kryejë import të mallrave me përdorim të dyfishtë, si përdorues fundor.



- vi. Të kryejë aktifitete jo bankare dhe fianciare në përputhje me legjistacionin shqiptar dhe rregullat në fuqi të mirattuara nga autoritetet rregullatore, të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në mbledhjen dhe transferimin e parave.
- vii. Kryerja e të gjitha veprimtarive në lidhje me regjistrimin dhe shitjen e domeineve.
- viii. Furnizimi tregtar dhe shpërndarja e telekomunikacionit, të dhëna zanore, transmetimi i të dhënave dhe pajisjet fiskale, si dhe produkte komunikimi dhe aksesorë për dhe në lidhje me shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimeve audiovizive. Ofrimin e shërbimeve të asistencës teknike dhe mirëmbajtjen e telekomunikacionit, të dhënave zanore, transmetimin e të dhënave dhe pajisjet fiskale.
- ix. Kryerja e transmetimeve audio dhe audio vizuale dhe ritransmetimi përmes shërbimeve të telekomunikacionit për transmetimet audio dhe audiovizive dhe ritransmetimet e çdo lloji, si dhe shitja e shërbimeve dhe produkteve audio dhe video në përputhje me legjistacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, dhe aktet nënligjore përkatëse të aprovuara nga autoritetet rregullatore kompetente.
- x. Ofrimi i edukimit profesional ndaj punonjësve dhe bashkëpunëtorëve në zbatim të ligjistacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe Rregulloret përkatëse të aprovuara nga autoritetet rregullatore kompetente.

Neni 4
Selia

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Muhedin Llagami”, Kompleksi Square21, Tirana, Albania.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e ekzistencës së Shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 6
Adresa e faqes së internetit dhe adres elektronike

6.1 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është www.one.al.

6.2 Adresa e e-mailit të Shoqërisë për qëllimet e komunikimit elektronik është contactus@one.al.

KREU II
KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 7
Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar

7.1 Kapitali aksionar i nënshkruar dhe i paguar është 863,826,822 ALL, i përbërë nga 863,826,822 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1 ALL (një) për secilin aksion. Secili aksion është i pandashëm dhe siguron një votë.

7.2 Në rast të rritjes së kapitalit të Shoqërisë, aksionet e reja u ofrohen aksionerëve me opzion të drejtë paraprake në përpjesëtim me numrin e aksioneve të zotëruara, sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

Neni 8
Kalimi i Aksioneve me Kontratë

8.1 Kontrata për kalimin e aksioneve do të bëhet me shkrim dhe parashikon kalimin e të drejtës reale (e drejta *in rem*) të pronësisë së aksioneve.

Neni 9
Kalimi i aksioneve me anë të trashëgimisë, si pasojë e falimentimit, Riorganizimit ose Ndryshe

9.1 Një person që gjzon të drejtë ligjore mbi një aksion si shkak i trashëgimisë, falimentimit, riorganizimit ose ndryshe, do të fitojë të drejtën reale (e drejta *in rem*) të pronësisë mbi atë aksion në momentin që ai regjistrohet si zotërues i aksionit në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë.

9.2 Personi që ka fituar një aksion sipas paragrafit (9.1) të këtij Neni do të ketë të drejtën për të gjithë dividentët e shpërndarë pas momentit që ka lindur e drejta për një aksion të tillë.

KREU III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 10
Asambleja e Përgjithshme

10.1 Organi vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga të gjithë aksionarët e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të jetë e zakonshme (rezoluta të shumicës së thjeshtë) ose e jashtëzakonshme (rezoluta të shumicës së kualifikuar). Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend të ndryshëm nga selia, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

10.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Bordi i Administrimit ose nga Administratori. Mund të mblidhet edhe sipas neneve 136 e vijuese të Ligjit Tregtar.

10.3 Modalitetet e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme rregullohen me nenin 137 të Ligjit Tregtar. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme u njoftohet aksionarëve me publikimin e informacionit përkatës në një gazetë të përditshme shqiptare që shpërndahet në të gjithë territorin shqiptar, si dhe në faqen e internetit të Shoqërisë. Nëse shihet e përshtatshme, Shoqëria mund të njoftojë thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme me postë të rregullt ose me postë elektronike. Njoftimi i Asamblesë së Përgjithshme bëhet jo më vonë se 21 ditë nga data e mbledhjes së njoftuar të saj.



- 10.4 Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e thirrur e vlefshme nëse nuk respektohen formalitetet që rregullojnë thirrjet, me kusht që të gjithë aksionarët e Shoqërisë të janë të pranishëm në mbledhje dhe shprehimisht të bien dakord për marrjen e vendimeve, sipas nenit 138/4 të Ligjit Tregtar.
- 10.5 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Administratori i Shoqërisë ose, në vend të tij, nga një aksionar i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme ("Kryetari i Asamblesë"). Kryetari i Asamblesë emëron një Sekretar për mbledhjen, i cili mund të jetë ose jo aksionar.
- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mbahet të paktën një herë në vit, jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit fiskal, për të diskutuar, analizuar dhe miratuar raportet financiare të vitit të kaluar. Asambleja e Përgjithshme thirret për të gjitha çështjet e parashikuara nga Ligji Tregtar, veçanërisht sipas nenit 136 të tij.
- 10.7 Aksionarët mund të zgjedhin të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme nga një aksionar tjeter ose nga një person i tretë, në përputhje me nenin 140 të Ligjit Tregtar. Në këtë rast ata duhet të paraqesin një prokurë me shkrim.
- 10.8 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, si dhe të drejtat e aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, dhe të përcaktojë nëse ajo është thirrur në rregull dhe nëse kuorumi i nevojshëm i aksionarëve është i pranishëm dhe mund të miratojë vendime të vlefshme. Kryetari i Mbledhjes ka gjithashtu të drejtën të udhëheqë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.
- 10.9 Procesverbalet e mbledhjeve nënshkruhen nga Kryesuesi i Mbledhjes dhe nga Sekretari, siç parashikohet në nenin 143 të Ligjit Tregtar.
- 10.10 Asambleja e Përgjithshme mund të mbajë gjithashtu mbledhje dhe të marrë vendime të vlefshme nëpërmjet komunikimeve me shkrim, faksit, e-mailit dhe shërbimeve postare. Një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme mund të miratohet me qarkullim me shkrim, pra pa thirrur ose mbajtur një mbledhje.
- 10.11 Aksionarët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të marrin pjesë dhe të votojnë nëpërmjet mjeteve elektronike përfshirë telekonferencën (conference call), siç parashikohet nga neni 142 i Ligjit Tregtar.

Neni 11

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

11.1 Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Të miratojë çdo ri-organizim, shkrirje, konsolidim, bashkim apo shpërberje të Shoqërisë.



- b) Të miratojë krijimin, alokimin apo emetimin e çdo aksioni apo letra me vlerë në kapitalin e Shoqërisë.
- c) Të miratojë çdo çështje në lidhje me shpërndarjen, mos-shpërndarjen e dividenteve, destinimin e dividenteve si dhe çdo shpërndarje të rezervave statutore.
- d) Të ushtrojë çdo kompetencë të dhënë nga ligji apo Statuti.

11.2 Secili aksionar i Shoqërisë ka të drejtë t'i kërkojë administratorit/ve të shoqërisë informacione në lidhje me llogaritë vjetore të Shoqërisë ose të ndonjë Filiali, duke përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet përkatëse në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë ose të Filialit, raportet e organeve drejtuese të Shoqërisë së Filialit ose raportet e auditorëve të jashtëm dhe çdo dokument apo informacion tjetër që nuk është klasifikuar si sekret tregtar nga Shoqëria.

**Neni 12
Votimi**

12.1 Në përputhje me të drejtat dhe kufizimet që rrjedhin nga aksionet, secili aksion i jep të drejtën e votës zotëruesit të tij.

12.2 Aksionari, gjatë zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme, mund të votojë: (i) personalisht; (ii) nëpërmjet një përfaqësuesi të caktuar me prokurë; ose (iii) kur njoftimi i thirrjes e parashikon këtë me anë të një mjeti elektronik të sigurt.

**Neni 13
Emërimi i Ekspertit Kontabël të Miratuar**


13.1 Me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik ose një Shoqëri Ekspertësh Kontabël të Autorizuar si Ekspertë Kontabël të Autorizuar.

**KREU IV
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**Neni 14
Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës**

14.1 Asambleja e Përgjithshme, emëron të paktën 3 ose më shumë persona fizik, gjithmonë një numër i cili nuk kalon numrin 21, si Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Asambleja e Përgjithshme shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në çdo kohë pa shkelur të drejtat që lindin nga marrëveshja përkatëse e shërbimit e lidhur midis anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Shoqërisë.

14.2 Në momentin e miratimit të këtij Statuti anëtarët e mëposhtëm janë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës deri në zëvendësimin e tyre nga një mbledhje e ardhshme e Asamblesë së Përgjithshme:



1. **Z. Gábor Tomcsányi** – Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës.
2. **Z. András Kunosi** – Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.
3. **Z. Zoltán Simon** – Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 15

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe Komiteteve të tij

15.1 Këshilli Mbikëqyrës nuk do të marrë pjesë në menaxhimin e Shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga drejtoret.

15.2 Këshilli Mbikëqyrës mund të themelojë komitete me qëllimin kryesor për të rritur efikasitetin e këshillit mbikëqyrës duke siguar që vendimet e informuara të merren nga këshilli mbikëqyrës si dhe të sigurohet që nuk ka konflikt material interes i vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës.

15.3 Këshilli Mbikëqyrës ka kompetencat e mëposhtme:

- a) miratimin e themelimit të çdo Filiali, si dhe miratimin e çdo riorganizimi, shkrirjeje, konsolidimi, bashkimi ose shitjeje të një filiali.
- b) miratimin e çdo fillimi të aktivitetit të ri, i cili është pjesë e linjës jo-thelbësore të biznesit ose është ndihmës i veprimtarisë kryesore të shoqërisë, brenda objektit dhe qëllimit kryesor të veprimtarisë së Shoqërisë.
- c) miratimin paraprak të miratimit dhe ndryshimit të dokumenteve përbërëse të çdo filiali dhe emërimin e organeve të tyre të qeverisjes së korporatës.
- d) miratimin paraprak të krijimit, ndarjes, anulimit ose emetimit të çdo aksioni ose letrave të tjera me vlerë në kapitalin e secilit filial.
- e) miratimin paraprak të çdo ndryshimi, plotësimi ose zëvendësimi të dokumenteve kushtetuese të çdo Filiali (përveç çdo ndryshimi, plotësimi ose zëvendësimi që është i nevojshëm për të respektuar çdo ligj në fuqi).
- f) miratimi paraprak i çdo ndryshimi të llojit, të drejtave ose formës së çdo grapi aksionesh ose krijimi i një grapi ose lloji të ri aksionesh në ndonjë filial.
- g) miratimin paraprak të çdo reduktimi të kapitalit aksionar të një filiali.
- h) miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit me çfarëdo mënyre të një ose të të gjitha aksioneve në çdo filiali.
- i) miratimi i përshkrimit të detyrave të çdo komisioni të Këshillit Mbikëqyrës.
- j) miratimin e çdo detyrimi financiar që ka një vlerë më të madhe se 5% të aktiveve të Shoqërisë që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare.
- k) miratimin e strukturës organizative të Shoqërisë dhe ndryshimet në strukturën organizative, duke përfshirë përcaktimin e funksioneve dhe personelit të çdo miratimi të politikave të menaxhimit dhe shpërbllimit të punonjësve të Shoqërisë, dhe çdo ndryshim eventual.
- l) miratimin e çdo plani kyç për zhvillimin e Shoqërisë siç vendoset herë pas here.
- m) miratimin paraprak për lidhjen e një kontrate nga ana e Shoqërisë apo ndonjë filiali që përfshin një dispozitë jo-konkurruese.
- n) miratimin e politikave kontabël dhe çdo ndryshim në politikat kontabël ose datën e referencës kontabël të Shoqërisë apo të një Filiali, në përpunje me legjislacionin në fuqi.



- o) propozimin për emërimin ose shkarkimin e auditorëve të Shoqërisë ose propozim paraprak për një çeshtje të tillë për ndonjë Filial.
- p) propozimin për deklarimin ose pagesën e çdo dividenti nga Shoqëria.
- q) miratimin paraprak të propozimit për deklarimin ose pagesën e çdo dividendi apo shpërndarjen nga ndonjë Filial.
- r) vendimet për thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve.
- s) marrjen nga Bordi i Drejtoreve të raporteve mujore, tremujore dhe vjetore për zbatimin e strategjisë, planin operacional dhe buxhetin e shoqërisë.
- t) të gjitha kompetencat e tjera të parashikuara nga ligji ose statuti.
- u) secili anëtar i Bordit Mbikëqyrës do të ketë të drejtë të kërkojë nga administratori/ët e shoqërisë ose të filialit, të shqyrtojë çdo kontratë, të lidhur nga shoqëria ose filiali, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse në procedurën e prokurimit.
- v) të marrë të gjitha raportet nga Auditit i Brenshëm.

Neni 16
Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës

- 16.1 Këshilli Mbikëqyrës duhet të mblidhet të paktën dy herë në vit ose më shpesh nëse do të kërcohët nga nevojat e mbarëvajtjes së biznesit të Shoqërisë.
- 16.2 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në takim përmes mjeteve elektronike përfshirë dhe tele konferencën. Anëtarët që marrin pjesë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik kanë të drejtë të votojnë përmes PIN-it që ju ëshë dhënë atyre praprakisht.
- 16.3 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës caktojnë një anëtar si kryetar të mbledhjes për të drejtar mbledhjen. Nëse kryetari nuk është present në 50 minutat e para duke filluar nga koha e cila është përcaktuar si koha e fillimit të mbledhjes, anëtarët pjesëmarrës do të zgjedhin njërin prej tyre për të drejtar mbledhjen.
- 16.4 Çeshtjet e axhendës do të zgjidhen nga pjesëmarrësit me shumicë votash. Në rastin kur votat janë të barabarta, vota e kryetarit do të jëtë vendimtare.
- 16.5 Vendim me shkrim i nënshkruar nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës do të konsiderohet i vlefshëm dhe efektiv sikur të ishtë aprovuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e cila është thirrur dhe mbajtur siç duhet.

Neni 17
Procesverbalet e Mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës

- 17.1 Këshilli Mbikëqyrës do të jetë përgjegjës për mbajtjen e sigurt procesverbaleve të:

- a) Të gjitha mbledhjeve të mbajtura nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe
- b) Të gjitha mbledhjeve të mbajtura nga Këshilli Mbikëqyrës dhe komitetet e tij, përfshirë emrat e drejtoreve prezent në mbledhje.



Neni 18
Paga e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

18.1 Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të shpërblehen nëse një shpërblim i tillë miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V
BORDI I ADMINISTRATORËVE/DREJTORËVE

Neni 19
Emërimi i Administratorëve/Drejtoreve

19.1 Shoqëria menaxhohet nga Bordi i Administratorëve i përbërë nga një numër nga 3 (tre) deri 9 (nëntë) Drejtore, të emëruar nga Këshilli Mbikqyrës.

19.2 Këshilli Mbikëqyrës emëron persona fizik si Administrator dhe Drejtor Ekzekutiv të Shoqërisë për një periudhë tre-vjeçare. Emëri me tilla do të bëhen me anë të një vendimi të Këshillit Mbikëqyrës të miratuar me shumicë të thjeshtë votash. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Bordit të Administratorëve, ndërsa Administratorët e emëruar, dhe, nëse është e nevojshme, një Zëvendës Kryetar dhe një ose më shumë Manaxher Drejtues.

19.3 Një anëtar i Këshillit Mbikqyrës nuk mund të emërohet si Administrator. Kufizime të tjera në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të Nenit 158 të Ligjit.

19.4 Drejtori Ekzekutiv përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Këshilli Mbikëqyrës mund t'i japë fuqinë për të përfaqësuar Shoqërinë (bashkarisht ose veçmas) çdo Administratori tjetër.

19.5 Personat e mëposhtëm janë Administratorë të Shoqërisë në momentin e miratimit të këtij Statuti:

1. **Z. Krisztián Fekete** në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Administratorëve.
2. **Z. Emil Petkov Georgakiev** në cilësinë e Anëtarit dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë.
3. **Z. Róbert Budafoki** në cilësinë e Anëtarit të Bordit të Administratorëve.
4. **Z. Csaba Ferenc Thurzó** në cilësinë e Anëtarit të Bordit të Administratorëve.
5. **Z. Aladin Ádám Linczényi** në cilësinë e Anëtarit të Bordit të Administratorëve.
6. **Z. László Blénessy** në cilësinë e Anëtarit të Bordit të Administratorëve.

Neni 20
Kompetencat e Bordit të Administratorëve/Drejtoreve

20.1 Bordi i Administratorëve ka kompetencat e mëposhtme:

- a. Fillimi i një mbyllje vullnetare, likujdimi apo falimentimi të një Filiali.
- b. Disponimi me çfarëdolloj mënyre të çdo, ose të gjitha aksioneve në ndonjë Filial pasi të jetë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.



- c. Blerje apo disponimi nga çdo Filial i askioneve apo interesave në kapitalin aksionar tek palët e treta.
- d. Miraimi i çdo detyrimi financiar me një vlerë deri në 5% të aseteve te Shoqërisë sipas pasqyrave të fundit financiare.
- e. Miratimi i aplikimit për licensa të reja thelbësore për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit (me përjashtim të rinovimit të licensave ekzistuese ose të licensës së re të bëra gjatë aktivitetit normal tregtar) përveç se kur ëeto duhet të miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës nëse bëjne pjesë në vlerat të cilat janë në kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës.
- f. Miratimin e përfundimit dhe ndryshimet në kushtet materiale të çdo licence materiale për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit.
- g. Miratimi i çdo çështje që ndikon materialisht në strategjinë e biznesit të Shoqërisë ose Filialit.
- h. Miratimi i Politikave të Qeverisjes së Shoqërisë.
- i. Kompetenca të tjera dhënë nga ligji apo nga Statuti.

20.2 Pavarësisht nga paragafi i mësipërm, të gjitha ose një pjesë e kompetencave të Bordit të Administratorëve mund t'i jepen një drejtori individual ose një grupi drejtorësh me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 21 Mbledhja e Administratorëve

21.1 Kryetari thërret mbledhjen e Bordit të Administratorëve, sipas axhendës, në çdo moment që ai e vlereson si të nevojshme ose në rast se ai merr një kërkesë me shkrim nga të paktën një anëtar i Bordit të Administratorëve. Kërkesa duhet të përbajë çështjet të cilat do të trajtohen. Nëse Kryetari refuzon të thërrasë mbledhjen brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e kërkesës, mbledhja mund të thirret nga Drejtori kërkues. Bordi i Administratorëve thirret me anë të një njoftimi të dërguar me email. Nëse Kryetari mungon ose për arsyet e tij i kalon në Zëvendës Kryetarit. Bordi i Administratorëve mund të marrë vendime të vlefshme, edhe nëse nuk bëhet një njoftim formal për mbledhjen, me kusht që të jenë prezent të gjithë Administratorët.

21.2 Bordi emëron një Sekretar për të mbajtur procesverbalet dhe për t'i vërtetuar ato si të sakta duke i nënshkruar ato bashkë me Kryetarin ose, nëse ky i fundit mungon, me njërin nga anëtarët prezent. Sekretari mund të jetë një person i cili nuk është anëtar i Bordit.

21.3 Mbledhjet e Bordit do të mbahen të paktën një herë në tre muaj, në zyrën e regjistruar të Shoqërisë ose në vendndodhje tjeter, në Shqipëri ose jashtë, dhe mund të drejtohen gjithashtu me tele-konferencë ose video-konferencë apo me mejte të tjera të ndashme, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe do t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të. Nëse ekzistojnë këto kushte, mbledhja e Bordit të Administratorëve është konsideruar të jetë mbajtur aty ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

21.4 Mbledhjet e Bordit të Administratorëve do të konsiderohen si të vlefshme nëse janë prezent shumica e Drejtorëve. Vendimet e Bordit të Drejtorëve do të janë të vlefshme nëse miratohen



nga votat pro të shumicës së Administratorëve prezent në mbledhje. Në rast barazie në vota, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

Neni 22
Procesverbalet e Mbledhjes së Administratorëve

22.1 Administratorët do të janë përgjegjës për mbajtjen e sigurtë të procesverbaleve:

- a) Të të gjitha mbledhjeve të mbajtura nga drejtoret; dhe
- b) Të të gjitha mbledhjet të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 23
Shpërblimi i Anëtarëve të Bordit të Administratorëve

23.1 Anëtarët e Bordit të Administratorëve mund të shpërblehen nëse një shpërblim i tillë miratohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

KREU VI
NJOFTIMET

Neni 24
Njoftimet


24.1 Të gjitha njoftimet e vlefshme të çdo personi për Shoqërinë në përputhje me Statutin duhet të jepen në formën e shkruar ose me mjet elektronik në adresën e dhënë në Nenin 4 të Statutit.

24.2 Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke dërguar me letër në adresën e regjistruar të aksionarit në fjalë ose në adresën apo postën e tij/saj elektronike. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët.

KREU VII
NDRYSHIME QË NUK PËRBËJNË NDRYSHIME TË KËTIJ STATUTI

Neni 25
**Ndryshimet e Administratorëve, Këshillit Mbikqyrës dhe Aksionarëve, Kapitali nominal,
Numri i aksioneve, Ekspertët Kontabël të Autorizuar**

25.1 Emrat e Administratorëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe Aksionarëve, Kapitali nominal, numri aksioneve, Ekspertët Kontabël të Autorizuar, të përmendura në këtë Statut, i referohen Administratorëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe Aksionarëve, Kapitali nominal, numrit të aksioneve, Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në momentin e miratimit të këtij Statuti.



25.2 Çdo ndryshim, zëvendësim ose shkarkim i Administratorëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ose Aksionarëve, kapitalit nominal, numrit të aksioneve, Ekspertët Kontabël të Autorizuar, nuk do të përbëjnë një ndryshim të këtij Statuti dhe do të miratohen në përputhje me Ligjin.

Neni 26
Dispozitat e Veçanta

26.1 Nëse një kusht i këtij Statuti është ose bëhet i pavlefshëm ligjërisht ose i pazbatueshëm në çdo aspekt kjo nuk do të cenojë ligshmërinë, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kushteve të tjera të këtij Statuti.

Albania Telekom Invest AD

RIS PËRUEZUJ 

4iG Albánia Kft.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Posta Shqiptare SHA

Të tjerë
